



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 19.3.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.3.2012,
3. Gjendja në sektorin e ujërave dhe veprimtaria e “Task-Force” për ujëra,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.3.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.3.2012.

3. Shqyrtimi i gjendjes së ujërave në Kosovë dhe puna e TASK FORCE për ujëra

Nait Hasani falënderoi z. **Baton Begolli**-këshilltar i jashtëm pranë zyrës së kryeministrit për çështje të ujërave, për përgjigjen në ftesën e Komisionit rreth temës për ujëra, e cila sfidë është e paraparë edhe në raportin e progresit për këtë vit. Z. Begolli gjithashtu falënderoi për bashkëpunim dhe fillimisht japi sqarime rreth gjendjes së ujërave në Kosovë ku uji i pijes faturohet 66%. Në raportin e progresit, vazhdoi, nuk kanë parashtruar ndërkombëtarët pyetjen rreth trajtimit të ujërave të zeza, ngase nëse nuk respektohet uji i pijes, pyetja logjike është pse të bisedohet për ujërat e zeza, për të cilat edhe nuk kemi impiante të trajtimit (përveç në Skenderaj). 76% e popullatës ka qasje në ujin e pijshëm, ndërsa 24% kanë qasje përmes burimeve (bunarë). Situata tek minoritetet është më e mirë sesa tek shumica shqiptare. Në vazhdim njoftoi edhe për investime afatgjate dhe afat shkurta, mirëpo fatkeqësia sipas tij është se çështjen e ujërave nuk kemi shpallur prioritare, çka konsiderohet për të huajt shenj për mosinvestime. Megjithatë krijimi i Task Forcës për ujëra është një inkurajim për zhvillimin e këtij sektori. Sa i përket kompletimit të legjislativit, ai njoftoi se Qeveria në mbledhjen e fundit nuk ka miratuar projektligjin për ujëra për shkak të kostonë së lart financiare (përmbi 300 milion për këtë vit), ndaj në vijim parashihet korporatizimi i KRU-ve dhe krijimi i TFU (task forcës për ujëra) që është iniciuar nga zyra e kryeministrit për të ngritur profilin e ujërave. Për planin e pellgjeve lumore ai tha se është i mendimit se duhet të punohet sipas realitetit që kemi. Në punën e TFU janë mbajtur 6 takime, vendimet e së cilës pasqyrojnë situatën tonë të vështirë me ujëra e cila situatë medoemos kërkon shpalljen prioritet të çështjes së ujërave, ngase çdo gjë dhe çdo zhvillim varet pikë së pari nga gjendja e ujërave. Në emër të TFU ai kërkoi nga komisioni : përkrahje për miratimin e dokumentit për politikën ujore, prezantimin e trendëve të investimeve në sektorin e ujërave, prezantimin e studimit për mbulueshmëri me ujësjellës dhe sistem të kanalizimit dhe plotësimin e ligjit për ZRRUM të sponsorizuar nga ky komision.

Nait Hasani falënderoi dhe sqaroi se komisioni gjatë shqyrtimit të projektligjit për mbeturina ka përkrahur qasjen e MMPH për ZRRUM ndaj pyeti si është qasja edhe për ujëra sa i përket kësaj zyre. Z. Begolli gjithashtu pohoi se Qeveria dhe projektligji i propozuar injoron këtë zyrë mirëpo nuk ndërprehet bashkëpunimi dhe bashkëveprimi. Në vazhdim u bënë disa pyetje nga anëtarët e komisionit, **Daut Haradinaj** pyeti çfarë menaxhimi është ky nëse konstatohen këto humbje të mëdha të ujërave, dhe kërkoi të ceken dallimet midis menaxhimit regional dhe lokal. Z. Begolli tha se kjo më tepër ka të bëjë me trashëgiminë tonë të zymtë (keqpërdorime, rrjedhje, humbje teknike etj), madje edhe inkasimi 80% nga popullata nuk është tregues i saktë nëse dëshirojmë të njoftohemi për gjendje të tillë kush sa e ruan ujin, ndërsa lidhur me menaxhimin regional tha se ky menaxhim është kërkesë më tepër e ndërkombëtarëve ngase ata mendojnë se menaxhimi komunal është dështim. **Sevdije Lama** pyeti për ekzistimin e institutit hulumtues dhe a merr pjesë aty IKSHPK, përgjigja ishte pozitive por se instituti luan më tepër rolin e politikë bërjes me ministrinë përkatëse. E njëjta pyetje ishte nga **Nijazi Idrizi** por për hulumtime nëntokësore, përgjigja ishte se nuk ka studime të tilla por duhet të definohen në strategjinë që parashihet. Pyetjet në vijim ishin për pjesën lindore të Kosovës, ndërsa **Liburn Aliu** pyeti a parashihet që Task Forca të prioritetizoi punët rreth ujërave, ngase secili organ e arsyeton veten por a do të arrihen qëllimet në fund me gjithë këto organe (a do të dominoi niveli regional apo komunal i menaxhimit etj), këshilli i ujërave a do të ekzistoi. Z. Begolli tha se Këshilli do të zëvendësohet me këshillin ndërmnistror, ndërsa a do të arrihen qëllimet tani, vështirë është të përgjigjemi ngase duhet ti hyjmë punëve ashtu si dikton realiteti ynë. Sa më tepër duhet ti ikim shpenzimeve, për shembull një njësi për pellgjet etj., përfundoi. **Salih Morina** pyeti sa do të ndikoi thatësira në këto probleme me ujë. Përgjigja ishte se askush nuk mund të vërtetoi sa do të kemi probleme me thatësi, ngrohje globale, vërshime etj mirëpo projekti i UNDP do të zhvillohet edhe për këto çështje. Për liqenin e Ujmanit (Gazivodën) tha se Qeveria duhet të tregoi kujdes të veçantë dhe prioritet kombëtar ngase e tepërt është të flitet për rëndësinë që paraqet ky liqen. **Sylejman Berisha** nga Bordi Mjedisor u bashkëngjiti dhe theksoi rëndësinë e TFU me ndërlidhjen e profesionalizmit për ujëra në krijimin e kuadrove me master etj. **Afërdita Berisha** u pajtua por tha se nuk do të thotë që duhet master e tutje, ngase mjafton të thuhet profesionalizëm në këtë

lëmi, ndërsa **z. Sylejman Berisha** vazhdoi dhe potencoi çështjen e fusnotës që sipas mendimit të tij do të dëmtoi në politikat regjionale, ndaj sa do të ndikoj ende nuk dihet. **Afërdita Berisha** poashtu pyeti për përqindjen 76% që kanë popullata qasje në ujë, a është reale. Përgjigja ishte se nuk do të thotë se kanë, por në shumë vende rrjeti është përcjellë ende pa pasur ujë.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani në këtë pikë i renditi çështjet si vijon :

- rreth planit hapësinor me interes të veçantë, komisioni nxori për mbledhjen plenare si vijon :

R e k o m a n d i m

Të miratohet Plani hapësinor me interes të veçantë “Shtabi i përgjithshëm i UÇK në Kleçkë dhe Divjak”.

Arsyetimin e rekomandimit e paraqet kryetari i komisionit Nait Hasani.

- **Liburn Aliu** propozoi të ftohen përfaqësuesit e fshatit Dobërlluk (Komuna e Vushtrrisë) në një mbledhje të radhës rreth problemeve me plasimin e patateve në treg,
- kryetari **Nait Hasani** njoftoi për takimet me ICO dhe takimet që do të organizohen në vijim me kryesinë e komisionit dhe komisionin të mërkurën për projektligjin për fshatin Hoça e madhe, po të njëjtin ditë më 21 mars do të mbahet takimi në Vila GËRMI rreth projektligjit për ndërtimin,
- të enjten mbahet takimi i komisionit në Pejë rreth monitorimit të ligjit për mbrojtjen e natyrës me OJQ SYRI VISION,
- të premten është takimi në Prishtinë me REC dhe SORROS për çështje mjedisore,
- Kryetari njoftoi komisionin për vizitën në KEK dhe Komunën e Obiliqit,
- Mbledhja e rregullt e komisionit mbahet të hënën më 26 mars

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani